

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist prane OSSH / Drejtori** Rajonale / Dega Teknike / Sektori I Projektim Standartizim.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për bashkëpunimin me Njësitë/Agjensitë për kryerjen e studimeve të nevojshme për zhvillimin optimal të rrjetave shpërndarëse.
- Harton projekt preventivat për linjat dhe kabinat të cilat paraqesin probleme teknike që kanë nevojë për ndërhyrje/restaurime.
- Harton plane të investimeve të reja që nevojiten në të gjithë rajonin duke hartuar projekt preventivat për linjat dhe kabina transformacioni përkatës.
- Mbledh dhe menaxhon të dhënat e marra nga Sektori i Mirëmbajtjes për përcaktimin e zonave prioritare të investimeve.
- Përgjegjës për përgatitjen e kërkesave për hartimin e planit të investimeve për vitin pasardhës.
- Mbledh dhe menaxhon kërkesat për planin vjetor të meremetimeve të mëdha pas marrjes së kërkesave nga Sektori i Mirëmbajtjes.
- Mban marrëdhënie me institucionet lokale (Bashki dhe Komuna) për zhvillimet e reja urbanistike.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar Fakultetin e Inxhinjerisë Elektrike me rezultate të mira.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet.
- Të ketë njohuri për programet bazë të kompjuterit.
- Të njohë gjuhë të huaja, preferohet gjuha angleze.
- Aftësi shumë të mira komunikuese edhe punës në grup.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.